



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:173617

Datë: 10.03.2023

Numri i dokumentit: 04066521

K.nr. 574/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË- Deppartamenti i Përgjithshëm-Divizioni për Kundërvajtje, gjyqtarja Manduhije Sylja, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës **SH.P.K. “Com Petroll”** lagja Brekkoc K-Gjakovë, me pronar Ukë Nikollbibaj, me përfaqësuesin e autorizuar Gjon Nikmengjaj, me autorizim në shkresat e lëndës, për kundërvajtjen nga neni 13 par.2, neni 16 par. 1.2 sanksionuar nga ne i 19 par.8 nën par.8.1 të Ligjit Nr.08/L-18 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme si dhe neni 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Cilësinë e Karburanteve të Naftës, , e në bazë të nenit 55.2,77,86,124,127 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje me datë 10.03.2023 merr këtë:

A K T G J Y K I M

E PANDEHURA, SH.P.K. “Com Petroll”, me numër biznesi 811403732, e cila gjendet në rrugën ”Minatori” lagja Brekoc K-Gjakovë, me pronar Ukë Nikollbibaj.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Për shkak se me datë 27.02.2022, rreth orës 10:30 min., gjatë inspektimit të kryer nga ana e Inspektorëve të Tregut, në bashkëpunim me Trupat Inspektuese “SIERRA LAB” të autorizuar nga MINT në Subjektin Ekonomik SH.P.K. “Com Petroll”, person juridik, e cila gjendet në rrugën”Minatori” lagja Brekoc K-Gjakovë, me pronar Ukë Nikollbibaj, ku kanë marrë mostra të derivateve të lëngëta të naftës për Diezel dhe Benzine dhe pas arritjes së Raportit të testimit të cilësisë nga Laboratori testues Kosova-Lab, SH.A Prishtinë datë 29.07.2022, ka rezultuar se produkti i testuar Diezel nuk është konform me Parametrat e pikës së Ndezjes të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr.01/2017 për Cilësinë e Karburanteve të Lëngëta të Naftës, e cila duhet të jetë 55⁰C, ndërsa e njëjta ka rezultuar me 47⁰C pika e ndezjes. Gjatë ri testimit (Super analizës) të kryer në Laboratorin testues OKTA të Maqedonisë me datë 09.08.2022, ka rezultuar 43⁰C pika e ndezjes, jo konform me Parametrat e Pikës së Ndezjes te përcaktuar me UA nr.01/2017 që duhet të jetë 55⁰C,

-me veprim të këtillë ka kryer kundërvajtje nga neni 13 par.2 ,neni 16 par 1,2, sanksionuar nga neni 19 par. 8, nën par.8.1 të Ligjit Nr.08/L-018 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme si dhe neni 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Cilësinë e Karburanteve të Naftës, mbështetur në nenin 35 të LK-së , me aplikimin e dispozitave të përmendura,

D Ë N O H E T

Me dënim gjorbë në shumë prej 1500 (njëmijepesëqind) €, të cilën gjorbë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në të kundërtën do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Në emër të paushallit gjyqësor është i obliguar të paguaj shumën prej 10 €, konform nenit 59,76 të L.K-së, në të njëjtë afat sikurse dënimi .

A r s y e t i m

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë –Inspektori i Tregut në Prishtinë, me datë 24.08.2022, ka parashtruar gjykatës kërkesë me Nr.REF.19/2022, datë 19.08.2022, për fillimin e procedurës kundërvajtëse, kundër të pandehurës SH.P.K. “Com Petroll” person juridik, e cila gjendet në rrugën. “Minatori” lagja Brekoc K-Gjakovë, për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të përfaqësuesit të autorizuar të pandehurës SH.P.K. “Com Petroll” lagja Brekoc K-Gjakovë, me përfaqësuesin e autorizuar Gjon Nikmengaj i cili deklaroj se: me datë 27.02.2022, rreth orës 10:30 min., kanë qenë në Inspektim Inspektorët MIN, ku është marrë mostra e Karburantit Dizel dhe Benzinë dhe me datë 29.07.2022 ka arritur rezultati sipas Raportit të Inspektimit , ku parametri i testuar pika ndezëse e Dizeli ka rezultuar që është jo konform U/A, ku sipas rezultatit pikat ndezëse është 47 °C, ndërsa sipas U/A minimumi për pikën ndezëse është 55 °C., pas njoftimit lidhur me rezultatin jo konform U/A Nr.01/17 për cilësinë karburantit Dizel. Ne të pa kënaqur me këtë rezultat duke u nisur nga fakti se karburantet Dizel-Benzinë i blejmë në Tregun e Brendshëm dhe mendojmë se cili derivat që futet në Kosovë është me cilësi konform standardeve dhe duke u nisur nga ky fakt kemi kërkuar që bëhet një super analizë. Me datë 09.08.2022 përsëri jemi njoftuar se raporti i ri- testimit ka rezultuar jo konform U/A . Kërkoj nga gjykata duke pasur parasysh se është hera e parë që ky subjekt ka ra në ndesh me Ligjin , zotohem se subjekti në fjalë do të ketë kujdes të shtuar që në të ardhmen mos të përsëritet një veprim i tillë apo ngjashëm dhe të më shqiptoi një dënim me të butë seç parashihet me Ligj

Pranë kësaj gjykate është dëgjuar Inspektori i Tregut në MINT Elisja Beqiri, i cili në dëshminë e tij deklaroj se: me datë 27.07.2022, rreth orës 10:30 min., kemi qenë në Inspektorët tek subjekti ekonomik “Com Petroll” sh.p.k, me adresë Lagjja Breoc rruga “Minatori”, me numër unik 811403732. Në bazë të planit të rregullt të monitorimit të Cilësisë të Karburanteve të Naftës, në bashkëpunim me trupa Inspektuese “Sierra lab” SH.P.K, ku është marrë mostra karburantit Dizel dhe Benzinë për verifikimin e cilësisë. Me datë 29.07.2022 ka arritur rezultati sipas raportit i Inspektimit me nr.387./2022-TI-M ,ku parametri i testuar pika e ndezjes Karburantit Dizel rezulton që është jo konform udhëzimit Administrativ Nr.01/ 2017, ku sipas rezultatit pika e ndezjes është 47 °C , kurse sipas Udhëzimit Administrativ të lartë cekur minimumi për pikën e ndezës është 55 °C. Me datën 01.05.2022 njoftoji subjektin ekonomik që rezultati i arritur është jo konform U/A Nr.01/17 Për Cilësinë e Karburanteve- Dizel, me ç’ rast subjekti ekonomik i është dhënë mundësia drejtë ankese në afat prej 3 ditësh. Subjekti Ekonomik këtë të drejtë e ka shfrytëzuar dhe me datën 04.08.2022 ka parashtruar kërkesë për ri-testin (super analizë) në një laborator tjetër të akredituar . Pas arritjes së raportit të Ri-testimit me nr. 410/2022 – TI-M të datës 09.08.2022 ,Raporti i Ri-testimit tregon që mostra e Ri-testimit është bërë në laboratorin OKTA të Maqedonisë , ku edhe në këtë Raport rezulton që pika e ndezjes është jo konform U/A , ku pika e ndezjes e produktit Dizel është 43 °C , ku minimumi i pikës ndezjes duhet të jetë 55 °C.

Numri i lëndës: 2022:173617
Datë: 10.03.2023
Numri i dokumentit: 04066521

Kështu që në bazë të Raportove të lartë cekura ndaj subjektit në fjalë është iniciuar procedura Kundërvajtëse të Ligjit 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishmë, dhe kërkojmë që lënda të procedohet sipas Ligjeve në fuqi.

Nga të dhënat e parashtruara sipas kërkesës Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – Inspektori i Tregut në Prishtinë, procesverbali nr.000292 /22, datë 27.07.2022 dhe 000299/ 22 datë 01.08.2022, mbrojtjen e përfaqësuesit të autorizuar i cili pohon kundërvajtjen me të cilën ngarkohet e pandehura, deklaratën e inspektorit të tregut të dhënë në gjykatë datë 02.02.2023, të cilës dëshmi i fali besim provues, andaj Gjykata pas administrimit të të gjitha provave veç e veç dhe në lidhshmërinë me njëra tjetrën, konstatoi se e pandehura ka kryer veprë kundërvajtëse të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për çka është shpallur përgjegjës dhe dënuar me gjobë sipas Ligjit.

Me rastin e shqiptimit të gjobës gjykata mori për bazë rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parapara me nenin 31 të Ligjit për Kundërvajtje, peshën e kundërvajtjes, rrezikshmërinë shoqërore të sajë, shkallën e përgjegjësisë së të pandehurës, si rrethanë lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë, është hera e parë ka ra ndesh me ligjin, zotimi se në të ardhmen do të ketë kujdes të shtuar që mos të përsëritet një veprim i tillë a po i ngjashëm, andaj gjykata konform nenit 35 të LK-së, bën zbutje të dënimit nën minimumin e paraparë me ligj, duke konsideruar se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti pozitiv i sanksionimit dhe shmanget nga kryerja e veprave të këtilla dhe të ngjashme.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga një kopje të këtij aktgjykimit ti dorëzohet të pandehurës dhe parashtruesit të kërkesë.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Dep. i Përgjithshëm- Diviz. për Kundërvajtje
K.nr.574/2022, me datë 10.03.2023

Gjyqtarja
Manduhije Sylja

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët në procedurë mundë ushtron ankesë Gjykatës së Apelit-Divizionit për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjes së këtij aktgjykimi nëpërmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
VENDIM I DUE I PLOTËFQUISHËM
ODLUŠENJE PRAVNOOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
GJAKOVË - ĐAKOVICA
DIV. PËR KUNDËRVAJTJE / DIV. ZA PREKOŠAJ
Me/Datë 27.03.2023 20

Republika e Kosovës / Republika Kosovo
SARTËSINË E KOPJES E VËRTETON
DOKUMENT OTPRAVKA POTVRĐUJE
Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik

Lindita Rashiti

From: Hektor Vula
Sent: Wednesday, April 19, 2023 2:26 PM
To: Lindita Rashiti
Subject: FW: Vendimi i formës së prerë, K.nr.574.22
Attachments: K.574.22.pdf

Me respekt,

*Hektor Vula
Udhëheqësi i Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve
Gjykata Themelore Gjakovë
Zyra nr.002
Mob.Zyrtar +383 44 151510
Tel: +383 (0) 390 320803
Tel: +383 (0) 390 324130-154
Email zyrtar:hektor.vula@rks-gov.net*

From: Hektor Vula
Sent: Wednesday, April 19, 2023 2:16 PM
To: Lindita Rashiti <lindita.Rashiti@rks-gov.net>
Subject: Përshëndetje

Me respekt,

*Hektor Vula
Udhëheqësi i Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve
Gjykata Themelore Gjakovë
Zyra nr.002
Mob.Zyrtar +383 44 151510
Tel: +383 (0) 390 320803
Tel: +383 (0) 390 324130-154
Email zyrtar:hektor.vula@rks-gov.net*